

## Forcimi i Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut të Personave të Dënuar në Shqipëri

### Cili është qëllimi?

Projekti synon të përmirësojë mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personave të dënuar në Shqipëri duke asistuar autoritetet shqiptare në:

- ▶ prezantimin e një modeli efektiv për rekrutimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore dhe trajnimin e qëndrueshëm të stafit të shërbimit penitenciar;
- ▶ përmirësimin e dhënies së shërbimeve shëndetësore ndaj personave të dënuar, me fokus të vecantë tek të dënuarit me probleme të shëndetit mendor, duke përfshirë edhe zhvillimin e një strategjie për parandalimin e vetëvrasjeve;
- ▶ përgatitjen dhe pilotimin e programeve të rehabilitimit dhe ri-integrimit për të dënuarit që do të aplikohen paralelisht me sistemin standard të menaxhimit të riskut dhe nevojave;
- ▶ përmirësimin e trajtimit të diferencuar për grupet e të dënuarve vulnerabël

### Kush përfiton nga Projekti?

- ▶ autoritetet publike si: Ministria e Drejtësisë; Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- ▶ partnerët dhe palët e interesuara: Avokati i Popullit, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, organizatat e shoqërisë civile që ofrojnë shërbime për të dënuarit dhe persona në institucione të tjera të mbyllura;
- ▶ famljet e të dënuarve dhe shoqëria në përgjithësi

### Si do të funksionojë projekti?

- ▶ nëpërmjet shkëmbimeve të rregullta dhe koordinimit të ngushtë me përfituesit e projektit dhe partnerët në mënyrë që të identifikohen sfidat praktike dhe si rrjedhojë të zhvillohen metodologji të posaçme;
- ▶ nëpërmjet kombinimit të ekspertizës teknike dhe pjesëmarrjes në grupet e punës me përfaqësuesuesit e institucioneve përfituese me qëllim zhvillimin e materialeve të trajnimit të posaçëm, planeve të veprimit, praktikave të monitorimit, asistencës legjislative etj;
- ▶ nëpërmjet ndërtimit të kapaciteteve, zhvillimit të trajnimeve të posaçme sipas nevojave, si dhe zbatimit të programeve pilot me stafin e shërbimit penitenciar.

### Çfarë presim të arrijmë?

- ▶ projekti synon të ndihmojë në përmirësimin e aftësive organizative dhe performancën e sistemit penitenciar për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të njeriut për të dënuarit;
- ▶ të asistojë me identifikimin e masave të nevojshme për përmirësimin e kujdesit shëndetësor në burgje, veçanërisht për të dënuarit dhe pacientët me probleme të shëndetit mendor;
- ▶ të përmirësojë rehabilitimin e të dënuarve nëpërmjet aplikimit të një programi të mirëpërcaktuar për planifikimin e masës individuale të dënimit dhe programeve të ri-integrimit.

Financuar  
nga Bashkimi Evropian  
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet  
nga Këshilli i Evropës

## Sa do të kushtojë?

- ▶ Buxheti total i projektit është 640 000 EUR;
- ▶ Buxheti i alokuar për programin e përgjithshëm të Instrumentit Horizontal është përafërsisht. 41 Million EUR (85% financuar nga Bashkimi Evropian, 15% nga Këshilli i Evropës).

## Si të marrim informacion?

- ▶ Criminal Law Cooperation Unit of the Council of Europe: <https://www.coe.int/en/web/criminal-law-coop>
- ▶ Faqja e Internetit e Instrumentit Horizontal: <https://pjp-eu.coe.int/en/web/horizontal-facility/home>
- ▶ Marija Simić, Horizontal Facility Communication Officer, [Marija.Simic@coe.int](mailto:Marija.Simic@coe.int), +381 63 601 337
- ▶ Besnik Baka, Horizontal Facility Communication Officer, [Besnik.Baka@coe.int](mailto:Besnik.Baka@coe.int), +355 69 217 8430

## Për Instrumentin Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë

“Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019 – 2022” është një iniciative e përbashkët e Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës që i mundëson përfituesve të avancojnë axhendat e reformës në fushën e të drejtave të njeriut, shtetit ligjor dhe demokracisë në përputhje me standartet evropiane, duke përfshirë aty ku është e rëndësishme brenda kuadrit të procesit të zgjerimit të BE. Ky program tre vjeçar mbulon projekte në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mali I Zi, Maqedonia e Veriut, Serbi, Turqi si edhe Kosovë\* dhe zbatohet nga Këshilli i Evropës nga Maj 2019 deri në Maj 2022.

\* Ky shënim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

Këshilli i Evropës është organizata kryesore në kontinent për të drejtat e njeriut. Përbëhet nga 46 shtete anëtare, përfshirë këtu edhe gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjitha vendet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një traktat të krijuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin ligjor. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mbikëqyr zbatimin e Konventës në vendet anëtare.

[www.coe.int](http://www.coe.int)

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të lidhin së bashku njohuritë, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku, ata kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm duke ruajtur diversitetin kulturor, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është i përkushtuar të shkëmbejë arritjet dhe vlerat e tij me vendet dhe popujt përtej kufijve të tij.

[www.europa.eu](http://www.europa.eu)

*Ky dokument u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të merren në asnjë mënyrë për të pasqyruar mendimin zyrtar të secilës palë.*

Financuar  
nga Bashkimi Evropian  
dhe Këshilli i Evropës



Zbatohet  
nga Këshilli i Evropës